



Përmbledhje Nr.1 Të Bëjmë Rekomandime Efektive

Që në themelimin e saj në vitin 1977, Shoqata për Parandalimin e Torturës (SHPT) ka promovuar nje monitorim të rregullt dhe të pavarur në vendet e paraburgimit, si një mjet efektiv për parandalimin e torturës, keqtrajtimit dhe shkeljeve të tjera të të drejtave të njeriut. Ky Varg i ri Përmbledhjesh e bën analizën pioniere kërkimore të SHPT-së si dhe praktikat më të mira të homologëve, të disponueshme për praktikuesit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar në të gjithë botën.

Reagimet, komentet apo sugjerimet mbi përmbajtjen e këtij Vargu Përmbledhjesh janë të mirëpritura dhe të dërgohen në adresën: apt@apt.ch.

Nëntor 2008

Të Bëjmë Rekomandime Efektive

1. Hyrje

Shkruarja e raporteve dhe rekomandimeve kërkon aftësi të veçanta. Duke ditur kompleksitetin e çfarë mund të duket në fillim si detyrë e thjeshtë, drejtuesi praktike është i dobishëm dhe madje monitoruesit apo hartuesit me eksperiencë mund të përfitojnë duke rikonsideruar praktikatat e tyre në këndvështrimin e drejtuesve specialistë.

Ky dokument është hartuar për t'u lexuar dhe aplikuar nga çdo person që harton rekomandime si pjesë e ciklit të monitorimit të vendeve të paraburgimit. Është synuar veçanërisht të përdoret si një kornizë për analiza kolektive apo individuale apo rishikim të draft rekomandimeve përpara se të publikohen.

Ndërsa konteksti politik, ligjor, social, kulturor dhe lingvistik i çdo vendi do të ketë implikime për mënyrën se si rekomandimet janë shprehur, modeli **Double-SMART** i prezantuar më poshtë përcakton kriteret që mund të aplikohen sistematikisht me qëllim që rekomandimet të bëhen sa më efektive dhe të dobishme që të jetë e mundur.

2. Qëllimi i Rekomandimeve

Bërja e rekomandimeve përbën një pjesë themelore të ciklit të monitorimit. Dhënia e kohës së mjaftueshme për bërjen e tyre është thelbësore për disa arsye:

- Pa rekomandime, një raport i ka shanset e reduktuara për të arritur ndryshimin;
- Rekomandimet janë shpesh pjesë e raporteve monitoruese të paraburgimit që lexohen me shumë vëmendje;
- Ato janë rezultat i analizave eksperte shumedisipinëshe të kryera nga trupi monitories;
- Ato përcaktojnë dhe i japin prioritet veprimeve që duhet të bëhen për përmirësimin e respektimit të të drejtave të njeriut në situatat e privimit të lirisë;
- Ato duhet të japin një kontribut konstruktiv në zgjidhjen e problemeve kombëtare dhe të krijojnë një kornizë strukturore për dialog me autoritetet;
- Ato duhet të formojnë bazat për një vlerësim dhe ndjekje periodike si nga trupi monitories ashtu dhe nga vetë autoritetet.

3. Modeli i Rekomandimeve Double-SMART

Cilësia dhe dobishmëria e rekomandimeve të lidhura me monitorimin e paraburgimit mund të vlerësohen përkundrejt 10 kriterëve të mëposhtme të ndërlidhura dhe reciprokisht të mbështetura:

↔	S pecific	Specifike
↔	M easurable	Të matëshme
↔	A chievable	Të arritshme
↔	R esults-oriented	Rezultat orientuese
↔	T ime-bound	Kohë përcaktuese
	+	
↔	S olution-suggestive	Zgjidhje-sugjeruese
↔	M indful of prioritisation, sequencing & risks	Të kujdesshme për prioritetet, vazhdimësinë dhe rreziqet
↔	A rgued	Të debatueshme
↔	R oot-cause responsive	Shkak-origjinë reaguese
↔	T argeted	Të synuara

4. Konsiderimi i secilit kriter

Çdo kriter është i analizuar më poshtë dhe ndiqet nga pyetje dhe konsiderime vetë-kontrolluese si guidë për të siguruar përputhshmërinë ndaj tij. Duhet të kuptojmë që në konsiderimin e rekomandimeve sipas kriterëve **Double-SMART**, organizatat monitoruese mund të gjenden të detyruara të rishikojnë përmbajtjen e raporteve të tyre. Kjo mund t'i shtohet vetëm koherencës në procesin e përgjithshëm monitorues. Nëse rekomandimet nuk do të mund t'i plotësojnë të gjitha kriteret, përputhshmëria maksimale do të bënte ato të forta në mënyrë të konsiderueshme.

Specifike

Çdo rekomandim duhet t'i adresohet vetëm një çështjeje specifike. Secili rekomandim mundet gjithashtu të propozojë një ose më shumë veprime specifike por këto veprime duhen secila të jenë të përcaktuara dhe të ndara qartë me pika ose numra. Kjo do t'i ndihmonte autoritetet të kuptojnë dhe zbatojnë rekomandimet si dhe do të lehtësonte ndjekjen e tyre nga trupi monitorues. Duke ditur natyrën jo-specifike të rekomandimeve, një njoftim i përgjithshëm që t'ju kujtojë autoriteteve detyrën e tyre që t'i bëjnë kushtet e paraburgimit sipas standarteve ndërkombëtare dhe të garantojnë të drejtat e personave të privuar nga liria, mund të përfshihet në mënyrë të dobishme në një paragraf prezantues përpara rekomandimeve.

Pika-kontrolluese:

- ✓ A i adresohet rekomandimi vetëm një problemi apo çështjeje specifike?
- ✓ A janë pikat e veprimit individual të diferencuara qartë brenda rekomandimit?

- ✓ A janë të gjitha veprimet e propozuara të lidhura drejt për së drejti me brendinë e rekomandimit?

Të matëshme

Në të ardhmen autoritetet dhe organizatat monitoruese duhet të jenë në gjëndje të vlerësojnë pa ekuivoke nëse po apo jo dhe në çfarë mase është zbatuar një rekomandim. Rekomandimi duhet të jetë hartuar në atë mënyrë që vlerësimi të bëhet sa më lehtë të jetë e mundur. Kështu, raporti që shoqëron rekomandimet duhet të paraqesë nivelin e problemit duke ndërtuar një bazë për një krahasim në të ardhmen kur të jetë e mundur. Vëmendje i duhet kushtuar pro dhe kundër përdorimit të procesit apo rezultatit si dhe indikatorëve cilësorë apo sasiorë.

Pika-kontrolluese:

- ✓ A e jep qartë trunqun i raportit situatën aktuale?
- ✓ A përfshin apo nënkupton raporti apo rekomandimi një indikator për ndjekje të mëtejshme?
- ✓ A do të ishte e thjeshtë për një indikator të ndryshëm apo të modifikuar të verifikojë në të ardhmen?
- ✓ Deri në çfarë mase të dhënat e indikatorit do të jene të pakundërshtueshme?

Të Arritshme

Çdo rekomandim duhet synuar të jetë i realizueshëm në kuptim operativ. Megjithatë ky kriter nuk parashikon çështjen e burimeve financiare të disponueshme. Bazuar në standartet ndërkombëtare, rekomandimet duhet të nxjerrin në pah atë çfarë duhet bërë brenda arsyes. Është përgjegjësia e Shtetit të gjejë dhe përcaktojë burimet për ta bërë atë. Veprime shtesë apo alternative që mund të prodhojnë rezultatin e dëshiruar më lehtë apo e përforcojnë rezultatin, duhet të konsiderohen.

Pika-kontrolluese:

- ✓ A është zbatimi i këtij rekomandimi i mundshëm në kuptimin praktik?
- ✓ A ka veprime plotësuese apo alternative që mund të rekomandohen?
- ✓ Cilat opsione do të kishin rezistencë sado të vogël në drejtim të situatës?

Rezultat-orientuese

Përshkrimi dhe analiza e problemit duhet të vendoset në qendër të trupit të raportit dhe jo në rekomandim. Veprimet e sugjeruara në rekomandim duhet të çojnë drejtë një rezultati konkret. Kjo situatë e dëshiruar mund të jetë e nënkuptuar në rekomandim apo të jetë e përcaktuar konkretisht.

Pika-kontrolluese:

- ✓ A e përmban rekomandimi informacionin apo analizën që duhet të jetë në qendër të trupit të raportit?
- ✓ A e identifikon rekomandimi situatën e dëshiruar për të ardhmen dhe veprimet konkrete deri në shkallën e duhur apo thjesht jep përshkrimin e problemit dhe bën thirrje për ndryshim?

Kohë -përcaktuese

Duke përfshirë një kornizë kohore reale për zbatim i ndihmon autoritetet të kenë prioritete në dhënien e përgjigjeve, rrit presionin e veprimeve dhe shton përgjegjshmërinë. Koha për zbatim duhet të jetë e shprehur në muaj, vite apo zbatim i “menjëhershëm”. Ndryshe thënë, duhet vendosur një kornizë kohore afat shkurtër, afat mesëm apo afatgjatë por duhet të jetë dhënë qartë se çfarë nënkupton secila në kuptim numerik.

Pika-kontrolluese:

- ✓ A e identifikon rekomandimi fillimin apo përfundimin e zbatimit?
- ✓ A është kuadri kohor i shkurtër sa duhet, që të krijojë presion për ndryshim por është aq sa duhet i gjatë, për të marrë në konsideratë kërkesën kohore për zbatim?

Zgjidhje-sugjeruese

Pwr Rekomandimet që thjeshtë bëjnë thirrje për “ndryshim” apo “përmirësim” do të kërkohej një studim i mëtejshëm nga autoritetet përpara se të identifikohet një zgjidhje, duke lënë mënjanë zbatimin. Kjo redukton ndjeshëm mundësitë strategjike për arritjen e rezultateve konkrete. Një skuadër monitoruese shumë disiplinëshe aplikon ekspertizën profesionale, analitike etj. të anëtarëve të vet, për një çështje paraburgimi specifike dhe duhet kurdoherë që është e mundur të përpiqet jo vetëm të identifikojë problemet por të propozojë gjithashtu zgjidhje të besueshme. Veprimet e rekomanduara duhet të jenë konkrete dhe konçize por të përfshijnë detajet teknike përkatëse, që të shmanget keqzbatimi.

Pika-kontrolluese:

- ✓ A ka identifikuar analiza veprime konkrete që do të ndihmonin të kapërcehen problemet e identifikuar?
- ✓ A janë ato të përfshira në rekomandim?
- ✓ A është e nevojshme të përfshihen elementët teknikë apo të ndryshohet fraza në mënyrë që të shmanget keqinterpretimi apo zbatimi i gabuar?

Të kujdesshme për prioritetet, vazhdimësinë dhe rreziqet

Organizmat monitorues mund të identifikojnë shumë çështje që kërkojnë veprim. Megjithatë monitorimi parandalues është një proces në vazhdim, mbajtja rezervë e rekomandimeve me më pak presion mund të jetë e dobishme në mundësimin e autoriteteve zbatuese për t'u fokusuar në çështje më urgjente. Së dyti, disa rekomandime mund të bëhen më të suksesshme në raporte të mëvonta me të tjerat të zbatuara më parë. Së treti, monitoruesit duhet gjithashtu të analizojnë rreziqet që mund të dalin nga zbatimi në kuptimin e impaktit negativ lidhur me gëzimin e të drejtave të njeriut nga personat e privuar nga liria apo të tjerë. Konsekuencat negative të paparashikuara të zbatimit mund të dëmtojnë si inisiativën monitoruese parandaluese ashtu edhe autoritetet zbatuese.

Pika-kontrolluese:

- ✓ A janë disa prej rekomandimeve në raport më të rëndësishme e kështu duhet të vendosen të parat në listë?

- ✓ A do të ishte më mirë sikur të hiqeshin disa rekomandime me qëllim që autoritetet të fokusohen në më pak rekomandime që janë më shumë urgjente?
- ✓ A është zbatimi i disa prej rekomandimeve i varur nga zbatimi i të tjerave më parë?
- ✓ A mundet që zbatimi i ndonjë veprimi specifik të ketë impakt negativ lidhur me gëzimin e të drejtave të njeriut?

Të Debatueshme

Rekomandimet duhet të bazohen në fakte objektive dhe analiza të cilësisë së lartë të mbledhura gjatë ciklit të monitorimit dhe të sistemuara në trupin e raportit. Standartet ligjore përkatëse kombëtare dhe ndërkombëtare dhe ekspertiza profesionale (psh. mjeksore, psikologjike, menaxhim paraburgimi, punë sociale etj.) dhe praktikat më të mira që plotësojnë brendinë e tyre duhet të konturohen qartë dhe të aplikohen. Ky argumentim jep besueshmëri dhe ndihmon organizmat monitorues të mbrojnë pozicionin të tyre. Duhet mbajtur mend që standartet ndërkombëtare janë standarte *minimale* dhe mund të tejkalohen në rekomandime nëse organizmat monitorues e konsiderojnë të justifikueshme të bazuar në të drejtat e njeriut, profesionalizëm, praktikë më të mirë etj.

Pika-kontrolluese:

- ✓ A është problemi që adresohet nga rekomandimi i identifikuar qartë në pjesën qendrore të trupit të raportit?
- ✓ A është analiza e bazuar në fakte objektive, të verifikuara dhe cilësore?
- ✓ A identifikon analiza justifikimet përkatëse ligjore, profesionale dhe praktikës më të mirë për rekomandimin?
- ✓ A të çon analiza në mënyrë logjike dhe bindëse në rekomandimin përkatës?

Shkak-origjinë reaguese

Monitorimi duhet të përpiqet të identifikojë shkak-origjinën e problemeve, sistemeve apo proceseve që duhet të vihen në vend apo të modifikohen për të zbutur faktorët e rrezikut. Për rrjedhojë, rekomandimet duhet të drejtohen tek këto aspekte dhe jo tek simptomat. Kjo kërkon kontrollim-faktesh të kujdesshëm sikurse dhe një ri-analizim kritik. Kur nuk është e mundur të identifikohet shkak-origjina apo faktorët e zbutjes së rrezikut, duhet të mendohen veprime shtesë që mundësojnë përmirësimin dhe analizimin e mëtejshëm, të propozuara në një varg raportesh.

Pika-kontrolluese:

- ✓ A jepen simptomat e problemit (dmth.faktet) në pjesën qendrore të trupit të raportit?
- ✓ A i identifikon shkaqet analiza?
- ✓ A i adresohen drejt për drejt shkakut dhe jo simptomës veprimet e propozuara në rekomandim?
- ✓ Nëse shkakut i origjinës mbetet i papërcaktuar, a mund të aplikohet një qasje shtesë?

Të Synuara

'Qeveria' dhe 'shteti' nuk duhet të konsiderohen si entitete monolite. Aktorë apo institucione të veçanta që mund të zbatojnë rekomandimet ligjërisht dhe praktikisht duhet

të indentifikohen në mënyrë korrekte. Kjo do ta ndihmonte qeverinë në përcaktimin e përgjegjësive, rritjen e përgjegjshmërisë dhe lehtësimin e ndjekjes së procesit nga monitoruesit apo dhe shoqëria e gjerë. Në të njëjtën kohë, megjithatë, monitoruesit duhet të jenë të vetëdijshëm për protokollin institucional dhe të sigurojnë që hierarkitë të respektohen siç duhet si në vetë rekomandimet ashtu edhe në prezantimin e raportit. Disa raporte i grupojnë rekomandimet sipas sektorit të synuar (psh. gjyqësori, sistemi penitenciar, ministria e brendshme).

Pika-kontrolluese:

- ✓ Cilët aktorë specifik në hierarkinë institucionale mund të jenë më shumë në gjendje të zbatojnë rekomandimet në praktikë?
- ✓ A ka ndonjë autoritet në nivel më të lartë që duhet të japë autorizim, urdhër për veprim apo të jetë instrument në ndihmë të zbatimit?
- ✓ Cilët nga aktorët zbatues dhe autoritetet e tyre duhet të jenë të lidhur në mënyrë eksplicite me rekomandimet në një kendvështrim strategjik?
- ✓ Grupimi i rekomandimeve sipas sektorëve të synuar e rrit apo e redukton impaktin e tyre?

5. Aplikimi i Double-SMART në praktikë

Shikoni katër pyetjet në vijim të lidhura me tre palë draft-rekomandimet e mëposhtme:

1. Cili nga kriteret e **Double-SMART** nuk plotësohet nga versioni i parë në secilën palë?
2. Cili kriter i adresohet draftit të versionit të dytë?
3. Cili nga kriteret nuk është adresuar fare dhe pse?
4. Si mund të përmirësohet ndryshe rekomandimi?

Shembulli 1

- Brenda një muaji, Sekretari i Mirëqenies Sociale duhet të adresojë vulnerabilitetin ndaj dhunës së integritetit fizik të të rinjve gjatë transferimeve dhe kohës së transportimit të gjatë e të vonët për lëvizjen e të rinjve për në dhe nga ambjentet e gjykatës dhe midis qendrave të rehabilitimit.
- Ministri i Drejtësisë, Sekretari i Mirëqenies Sociale, Drejtori i Sistemit Penitenciar dhe Shefi i Policisë duhet të zhvillojnë brenda vitit tjetër një politikë strategjike operacionale për transferimin e të rinjve, në mënyrë që të sigurojë që:
 - Të rinjtë të mos transferohen në të njëjtin mjet me të rriturit;
 - Të paktën një oficer policie femër të jetë gjithmonë prezente kur bëhet transferimi i të rejave femra;
 - Një dispozitë e duhur të jetë bërë për ushqimin, ujin dhe nevojat fizike në udhëtimet që zgjasin më shumë se katër orë.
 - Të gjithë regjistrat e transferimit të jenë të plotësuar plotësisht.

Shembulli 2

- Incidentet e shumta të përdorimit të forcës së tepruar në vendet e paraburgimit duhet të reduktohen nga autoritetet.
- Çdo Drejtor Burgu duhet të sigurojë deri nga fundi i vitit ekzistues që të gjitha incidentet lidhur me përdorimin e forcës nga ana e stafit të regjistrohen në një regjistër të veçantë që duhet të përmbajë edhe emrin e anëtarit të stafit që bën regjistrimin e incidentit; kohën dhe datën e incidentit; emrat dhe pozicionet e personave të stafit të përfshirë dhe atyre prezent; emrat e personave të privuar nga liria që janë të përfshirë; një përshkrim të detajuar të incidentit përfshirë edhe arsyet e përdorimit të forcës; çdo pajisje e përdorur në incident; si dhe firma e oficerit mbikqyrës që shqyrtoi incidentin.

Shembulli 3

- Të reduktohet administrimi arbitrar i medikamenteve psikoaktive tek pacientët si një mjet shtrëngues.
- Autoritetet e spitalit duhet të sigurojnë brenda dymbëdhjet muajve që medikamentet anti-psikotik të administrohen sipas standarteve përkatëse ligjore, etike dhe mjeksore:
 - Duke zhvilluar udhëzues të qartë për përdorimin e tyre;
 - Duke siguruar që vetëm personeli mjekësor i kualifikuar dhe i caktuar specifikisht mund t'i administrojë ato;
 - Duke zbatuar një sistem të rregullt shumëdisiplinësh për rishikim.

6. Konkluzioni

Rekomandimet duhet të kërkojnë që të propozohen mënyra konkrete si të mund të adresohen çështje të të drejtave të njeriut në vendet e paraburgimit. Ato gjithashtu duhet të synojnë sa më shumë të munden, që të jenë të pakontestueshme nga këndvështrimi i atyre që *do-të-jenë* zbatues. **Double-SMART** jep një kuadër të përshtatshëm për vlerësimin kritik të draft rekomandimeve në përpjekje për të arritur këto qëllime.

Pas vendosjes së formatit përfundimtar të rekomandimeve, do të ishte e vlerësueshme për organizmat monitorues të konsiderojnë nëse është e nevojshme të rishikohet strategjia e planifikuar për nxjerrjen e raportit dhe ndjekjen e tij. Mënyra se si është ndërtuar raporti monitorues i paraburgimit dhe rekomandimet e tij, përfaqëson testin tjetër të rëndësishëm në ciklin monitorues të paraburgimit.

